



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 342/ 12 prot.

Datë 13.03.2024

V E N D I M
Nr. 279/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2024, shqyrtoi çështjen me

Objekt: 1. Korrigjim Vendimi

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK me NIPT L28029301Q, me adresë: Fshati Gurëz, afër ish kanalit të Acidit, Kurbin.

Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B, me adresë: Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.

Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë.

Agjencia e Prokurimit Publik.
Adresa: Bly. “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021 , datë 13.10.2021 e “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të

Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”; Neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Prokurimit Publik,

I

Vëren:

Në dispozitivin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 252/2024, datë 07.03.2024, ky Komision ka vendosur si më poshtë vijon:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*
- 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Arsyeton:

I.1. Me nismën e vetë organit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon që, në Vendimin e tij Nr. 252/2024, datë 07.03.2024, të bëjë korrigjimin e dispozitivit të vendimit si vijon:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e*

Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*

3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, si dhe nenit 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të korigjojë dispozitivin e Vendimit Nr.252/2024, datë 07.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik si më poshtë:

Ishte

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Vale Recycling” SHPK dhe “Eco Riciklim” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.

2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Bëhet

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “*Vale Recycling*” SHPK dhe “*Eco Riciklim*” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-94567-02-06-2024, me objekt: “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.02.2024 nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik Koço Gliozheni Tiranë.
 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “*Vale Recycling*” SHPK.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 18/21 prot, datë 18.02.2024, dhe Nr. 18/22 prot, datë 19.02.2024 dhe të publikoj shtojcën përkatëse të modifikuar.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Eco Riciklim*” SHPK
 5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

